



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 718/ Prot.

Tiranë, më 28 .07 .2026

VENDIM

Nr. 55, Datë 13.03.2026

**“PËR NGRITJEN NË DETYRËN E PROKURORIT NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME, TË PROKURORIT ANTONETA SEVDARI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.03.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për ngritjen në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, të prokurorit Antoneta Sevdari”**

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:**

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 718 prot., datë 05.03.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

## V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë<sup>1</sup>, si një ndër organet qeverisë të sistemit të drejtësisë garanton statusin e magjistratëve prokurorë, ku një aspekt të rëndësishëm zë karriera e tyre.
2. Në ushtrim të kompetencave të tij ligjore për zhvillimin e karrierës së prokurorëve, me Vendimin nr. 35, datë 03.03.2025, *“Për shpalljen e 3 (tre) vendeve vakante për procedurën e ngritjes në detyrë në Prokurorinë e Përgjithshme”*, Këshilli ka shpallur fillimin e procedurave për plotësimin e 3 (tre) pozicioneve vakante nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në Prokurorinë e Përgjithshme, si vijon:
  - Pozicion vakant nr. 1 në Prokurorinë e Përgjithshme;
  - Pozicion vakant nr. 2 në Prokurorinë e Përgjithshme;
  - Pozicioni vakant nr. 3 në Prokurorinë e Përgjithshme.
3. Të dhënat lidhur me subjektet që kanë të drejtë të kandidojnë, kushtet ligjore, afati i dorëzimit të shprehjes së interesit, dokumentacioni përkatës shoqërues, si dhe adresa ku do të dorëzohet shprehja e interesit janë njoftuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit në datë 05.03.2025.
4. Pas përfundimit të afatit të aplikimit në datë 20.03.2025, me Vendimin nr. 59, datë 27.03.2025, *“Për miratimin e listës së prokurorëve që kanë kandiduar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për vendet vakante në Prokurorinë e Përgjithshme, të shpallura me Vendimin nr. 35, datë 03.03.2025, të Këshillit”*, Këshilli ka miratuar listën e prokurorëve që kanë kandiduar për ngritje në detyrë për vendet vakante në këtë zyrë të prokurorisë.
5. Ndërsa, me Vendimin nr. 60, datë 27.03.2025, *“Për caktimin me short të relatorit për procedurën e ngritjes në detyrë për kandidatët që kanë kandiduar për vendet vakante në Prokurorinë e Përgjithshme, të shpallura me Vendimin nr. 35, datë 03.03.2025, të Këshillit”*, Këshilli ka hedhur shortin si dhe ka caktuar relatorët për ndjekjen e secilës prej procedurave të lëvizjes paralele. Për pozicionin vakant nr. 2, në Prokurorinë e Përgjithshme, si Relator ka rezultuar z. Sokol Stojani.
6. Me e-mailet e datave 31.03.2025, Relatori ka njoftuar aplikantët për caktimin e relatorit, për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tij apo çdo anëtar të Këshillit nëse ekziston një nga shkaqet e parashikuara në Ligjin nr. 115/2016, *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar ose për çdo shkak tjetër ligjor si dhe për fillimin e verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, nga ana e Këshillit.

Asnjë nga aplikantët nuk ka kërkuar përjashtimin nga procedura të Relatorit apo ndonjë nga anëtarët e Këshillit.

---

<sup>1</sup> Më tej, Këshilli

7. Me Vendimin nr. 122, datë 23.06.2025, “Për miratimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë për vendet vakante nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, në Prokurorinë e Përgjithshme, të shpallura me Vendimin nr. 35, datë 03.03.2025, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë për vendet vakante të shpallura sipas vendimit të Këshillit nr. 35, datë 03.03.2025 të sipërcituar.
8. Në pozicionin e shpallur vakant nr. 2 në Prokurorinë e Përgjithshme kanë kandiduar (në rend alfabetik), si më poshtë:
1. Antoneta Sevdari - prokuror pranë zyrës së prokurorisë Tiranë (preferencë e dytë);
  2. Marjeta Zaimi - prokuror pranë zyrës së prokurorisë Tiranë (preferencë e dytë);
  3. Pranvera Pustina – prokuror pranë zyrës së prokurorisë Tiranë (preferencë e dytë);
9. Në zbatim të nenit 32, pikat 2 - 7 dhe nenit 48, pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (në vijim, *Ligji për Statusin*), si dhe nenit 9, pika “dh”, të Vendimit nr. 222, datë 27.07.2022, “Për miratimin e Rregullores “Për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” (në vijim, *Rregullorja*), me vendimet respektive, Këshilli ka vlerësuar të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorëve, Antoneta Sevdari,<sup>2</sup> Marjeta Zaimi<sup>3</sup> dhe Pranvera Pustina<sup>4</sup>, kandidatë për prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, duke lejuar kështu vijimin e procedurës administrative përkatëse të ngritjes në detyrë.
10. Për pozicionin vakant nr. 1 ka aplikuar prokurori Pranvera Pustina dhe është kandidat i vetëm në garë. Aktualisht, në Komision është miratuar relacioni për ngritjen në detyrë të prokurorit Pranvera Pustina në detyrën e prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme në pozicionin e shpallur vakant nr. 1. Relacioni përkatës është njoftuar dhe pritet të miratohet në mbledhjen plenare. Duke qenë se, prokurori Pranvera Pustina eventualisht ngrihet në detyrë si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme për shkak të kushteve si më sipër, prokurori tjetër Marjeta Zaimi, nëpërmjet Kërkesës së regjistruar me nr. 558 prot., datë 18.02.2026, ka paraqitur heqjen dorë nga pozicioni vakant nr. 2, në Prokurorinë e Përgjithshme. Për rrjedhojë për këtë pozicion vakant (nr. 2) mbetet në garë si kandidatë e vetme prokurori Antoneta Sevdari.
11. Në këto kushte, Komisioni vlerësoi zbatimin e nenit 18, pika 2, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet:
- “1. Procedura administrative nuk i nënshtrohet ndonjë forme të caktuar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.*

<sup>2</sup> Vendim nr. 24, datë 29.01.2026 “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Pranvera Pustina, kandidatë për pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme”.

<sup>3</sup> Vendim nr. 29, datë 05.02.2026 “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Marjeta Zaimi, kandidatë për pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme”.

<sup>4</sup> Vendim nr. 30, datë 05.02.2026 “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të prokurorit Antoneta Sevdari, kandidatë për pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme”.

2. *Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.*”

12. Kandidati Antoneta Sevdari është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me Dekretin nr. 3475, datë 23.09.2002, të Presidentit të Republikës.

13. Prokurori Antoneta Sevdari është zgjedhur anëtare e Këshillit, me Vendimin datë 11.12.2018, të Asamblesë së Përgjithshme të Prokurorëve.

Ky emërim është ndërprerë me Vendimin nr. 47, datë 19.03.2019, të Këshillit, bazuar në Vendimin datë 28.02.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Ky i fundit, për shkak të vendimit të GjEDNj-së në çështjen “*Sevdari kundër Shqipërisë*” (aplikimi nr. 40662/19), me vendimin e datës 10.05.2024, vendosi konfirmimin e znj. Antoneta Sevdari në detyrë.

14. Megjithëse ushtrimi efektiv i kësaj detyre është ndërprerë për shkak të vendimmartjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, situata juridike e saj ka marrë një zgjidhje përfundimtare me vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit datë 10.05.2024, të dhënë në zbatim të Vendimit të GjEDNj-së në Çështjen “*Sevdari kundër Shqipërisë*”, me të cilin është vendosur konfirmimi i saj në detyrë.

15. Në vijim të këtij zhvillimi, Këshilli me Vendimin nr. 267, datë 31.07.2025, ka njohur shprehimisht vjetërsinë në punë si magjistrate për zonjën Sevdari për periudhën nga data 19.03.2019 deri më datë 11.03.2024, duke arsyetuar se njohja e plotë e kësaj periudhe është pjesë përbërëse e rivendosjes së plotë të të drejtave të saj profesionale, në kuptim të parimit të *restitutio in integrum*.

16. Ky vendim i Këshillit ka prodhuar pasoja të plota juridike, duke e konsideruar periudhën përkatëse si pjesë të pandërprerë të vjetërsisë së saj si magjistrate, me të gjitha efektet që lidhen me përparimin në karrierë, të drejtat që burojnë nga statusi dhe çdo element tjetër të lidhur me ecurinë profesionale. Për rrjedhojë, përvoja e saj si anëtare e Këshillit konsiderohet përvojë e plotë.

17. Prokurori Antoneta Sevdari ka rreth 23 vjet punë në funksionin e prokurorit, dhe në dosjen personale të administruar pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve nuk ka masë disiplinore në fuqi.

18. Në konkluzion të këtij relacioni, bazuar në nenin 48, pika 9, të Ligjit për Statusin dhe Krerët IV dhe V, të Rregullores, Komisioni i propozoi Këshillit ngritjen në detyrë në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, të kandidatit Antoneta Sevdari.

19. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë dhe kalimin në detyrë në mënyrë graduale, vlerësohet zbatimi i nenit 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të

Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se: “Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasojë juridike në një datë tjetër; të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar”, duke parashikuar konkretisht datën 24.03.2026.

### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenin 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe në nenet 24, pikat 1 dhe 2, 25, pika 5, dhe 36, të Vendimit nr. 222, datë 27.07.2022, “Për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

### V E N D O S I:

1. Ngritjen në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme, të prokurorit Antoneta Sevdari, duke filluar nga data 24.03.2026.
2. Të njoftohet me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Antoneta Sevdari.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 13.03.2026.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR**  
Mirela Bogdani

**ZV/KRYETAR**  
Erind Germenji

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Zeqir Hoda

**ANËTAR**  
Arta Mandro

**ANËTAR**  
Ledina Riza

**ANËTAR**  
Moisi Duda

**ANËTAR**  
Vatë Staka

**ANËTAR**  
Olger Eminaj

**ANËTAR**  
Erind Merkuri

**ANËTAR**  
Erion Fejzulla